

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Spitali i Pergjithshem- Pejë**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70030-26-3070-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material higjenik për nevojat e Spitalit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.T.SH. GIPA
NUI	600583323
Adresa	Rr. Luan Haradinaj p.n.
Vendi	Deçan
Kodi postar	51000
Numri Telefonit	049630900
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Milot Iberhysaj
Adresa elektronike	gipantsh@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	18.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me material higjenik për nevojat e Spitalit

•B05 Njoftim per Kontrat 12.05.2026

•B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara Dt:20.05.2026

•B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara Dt:25.05.2026

•Afati i fundit për dorëzimin e ofertave sipas njoftimit për kontratë 05.06.2026 ne ora 13:00

•Hapja e Ofertave të tenderit është bërë me dt. 05.06.2026 ora 13:00

•B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues me dt. 16.07.2026

•Krekës për qasje te dokumenteve Zyrtar me dt:17.07.2026

•Lejimi i kërkesës për qasjes me daten:17.07.2026

•Kerkes pe rishqyrtim 19.07.2026

•Vendim mbi kërkesën për rishqyrtim-07.08.2026

•Krekës për qasje te dokumenteve Zyrtar me dt: 07.08.2026

•Lejimi i kërkesës për qasjes me daten:10.08.2026

•Kerkes pe rishqyrtim 11.08.2026

•Vendim mbi kërkesën për rishqyrtim 13.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Refuzim i kërkesës për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 par.1 dhe 3 të ligjit nr.04/L-042 – Qëllimi.

Neni 7 par. 1 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042 - Barazia në Trajtim Jo Diskriminimi.

Neni 41 i Rregullave dhe UOPP-së - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Neni 51 të LPP nr 04/L-042 - Njoftimi i kriterëve të Përzgjedhjes.

Neni 52 Par 4 i LPP nr 04/L-042 - Njoftimi i Kriterëve për Dhënien e kontratës.

Neni 56 të LPP-së nr.04/L-042 - Dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe Dhënien e kontratave.

Neni 59 par.2 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve

Neni 60 par.2 i Ligjit nr 04/L-042 Kriteret për dhënien e Kontratës.

Neni 69 i LPP-së nr.04/L-042 - Aftësitë teknike dhe/ose profesionale.

Neni 72 i LPP-së nr.04/L-042 – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.

Neni 27 pika 27.13,27.14 dhe 27.15 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Gjatë kontrollit të dokumenteve që na është lejuar të qasemi me datën 10.08.2026 kemi gjetur shumë shkelje të ligjit të prokurimit publik.

kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58, me të cilin oferta e N.T.SH. GIPA është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.

N.T.SH. GIPA konsideron se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm dhe i mbështetur në një vlerësim **të pabarabartë** të ofertave, pasi nga qasja në dokumentet e aktivitetit të

prokurimit rezulton se **mospërputhje të njëjta ose të ngjashme teknike të konstatuara te oferta e GIPA-s nuk janë trajtuar në mënyrë të njëjtë te operatorët e tjerë ekonomikë.**

Sipas KRPP-së, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është përgjegjësi e AK-së, ndërsa një tender duhet të vlerësohet në raport me kërkesat e përcaktuara në DT dhe të njëjtat rregulla duhet të zbatohen në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët.

Gjetja e pare:

Sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit, në nenin **3.1** është kërkuar dorëzimi i **Specifikacionet teknike të detyrueshme,**

Nga dokumentet e qasura rezulton se KIGA **nuk ka dorëzuar specifikacionin teknik të kërkuar**, por ka dorëzuar vetëm një deklaratë ku shprehimisht thot se i përmbahet Specifikacionit teknik Aneksit 1 mirpo nuk i ka specifikuar artikujt sipas Aneksit 1 që sipas UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK në faqën 41 **ceket kjartë** : Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“specifikimit teknik” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar) **REFUZO TENDERIN PA KËRKUAR INFORMACION TË MËTEJSHËM**

Nëse FDT ka kërkuar shprehimisht **specifikacionet teknikt të detyrueshëm**, atëherë AK duhet **TA REFUZOJ TENDERIN.**

Gjetja e Dyte: SHKELJA E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË - Neni 7 par. 1 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042

Pretendimi kryesor i N.T.SH. GIPA është se **Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar standard të njëjtë gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të mostrave të operatorëve ekonomikë.**

Në rastin e N.T.SH. GIPA, AK ka konstatuar mospërputhje teknike dhe, pa bërë ndonjë vlerësim të njëjtë ose të barabart të të gjitha ofertave, ka vendosur eliminimin e ofertës tonë.

Mirëpo, pas ushtrimit të së drejtës për qasje në dokumentet e aktivitetit të prokurimit,

N.T.SH. GIPA ka konstatuar se **edhe operatorët e tjerë ekonomikë kanë dorëzuar mostra të cilat, sipas dokumenteve të tenderit, nuk përputhen me kërkesat teknike të përcaktuara nga vetë AK-ja.**

Pra, nuk kemi të bëjmë vetëm me faktin nëse një produkt i GIPA-s përmbush apo jo një kërkesë të caktuar, por me një çështje shumë më të rëndësishme:

Nëse një mospërputhje teknike është konsideruar arsye për eliminimin e GIPA-s, atëherë e njëjta kërkesë duhet të aplikohet në mënyrë të njëjtë edhe ndaj të gjithë operatorëve të tjerë ekonomikë.

KRPP ka theksuar se AK-të janë të obliguara të marrin masa për të siguruar **trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim ndërmjet Operatorëve Ekonomikë.**

Në këtë rast, nga dokumentet e qasura krijohet pikërisht situata e kundërt.

Në specifikimin teknik të Dosjes së Tenderit është kërkuar:

- 1. “Detergjent për rroba – 30% fosfat, 15% materie jonogjene aktive, sapun, etj.”**

Në arsyetimin për eliminimin e N.T.SH. GIPA-s, AK ka konstatuar:

“Sipas specifikimit teknik është kërkuar që produkti të përmbajë 30% fosfat. Mostra e dorëzuar përmban vetëm 15% fosfat, prandaj nuk i plotëson kërkesat teknike.”

Nga dokumentet e siguruara gjatë qasjes në dosjen e tenderit rezulton se **as mostrat e operatorëve të tjerë ekonomikë nuk dëshmojnë përmbajtjen prej 30% fosfat të kërkuar në DT.**

Në veçanti, nga etiketat e mostrave të operatorëve të tjerë ekonomikë nuk rezulton FARE përmbajtja e kërkuar prej **fosfat.**

Për këtë arsye, lind pyetja:

Nëse mungesa e 30% fosfatit është konsideruar mospërputhje materiale për eliminimin e GIPA-s, për çfarë arsye e njëjta mospërputhje nuk është trajtuar në të njëjtën mënyrë edhe te operatorët e tjerë?

“Dezinfektues per toalet (Domestos) 750ml.sadbumhypochlorite, 4.28% Selateyici

ajan,Su;95.72%”. sipas specifikimit të përcaktuar.

Nga qasja në mostrat e operatorëve të tjerë ekonomikë janë konstatuar këto të dhëna:

PM GROUP Mostra e dorëzuar deklaron rreth **4.076% sodium hypochlorite**, pra jo parametrin e kërkuar prej 4.28%.

KIGA Mostra e dorëzuar deklaron rreth **4.5%**, ndërsa në etiketë nuk rezulton qartë përbërja tjetër e kërkuar, përkatësisht raporti i përcaktuar në specifikim.

Për këtë arsye kërkojmë nga AK të sqarojë:

Përse mospërputhja e parametrave të mostrave të operatorëve të tjerë nuk është trajtuar me të njëjtin standard me mostrën e N.T.SH. GIPA-s?

“Sprej per xhama 750 ml. 5-15% alkohol-parfym-color etj.”

N.T.SH. GIPA është eliminuar me arsyetimin se:“Mostra e dorëzuar nuk përmban alkool.”

Megjithatë, nga qasja në mostrat e operatorëve të tjerë ekonomikë rezulton se edhe produktet e tyre **nuk deklarojnë alkool në përbërjen e produktit**, ndërsa në disa raste etiketa deklaron vetëm surfaktantë, parfum dhe përbërës të tjerë. Prandaj, edhe këtu paraqitet qartë çështja e **trajtimit të pabarabartë**.

Nëse mungesa e alkoolit është konsideruar arsye materiale për eliminimin e GIPA-s, atëherë e **njëjta mungesë duhet të ketë të njëjtin efekt edhe për operatorët e tjerë**.

Nuk mund të përdoret një kërkesë teknike si arsye për eliminim vetëm ndaj një OE-je, ndërsa i njëjti parametër të mos verifikohet ose të tolerohet te OE-të e tjerë.

“Vim i langet 450 ml. 15-30% aditiv”

Sipas specifikimit teknik është kërkuar: **15–30% aditiv** Nga shqyrtimi i mostrave të operatorëve ekonomikë PM GROUP dhe KIGA, **në etiketat e mostrave të dorëzuara nuk rezulton i deklaruar parametri i kërkuar prej 15–30% aditiv**.

Nuk mund të përdoret një kërkesë teknike si arsye për eliminim vetëm ndaj një OE-je, ndërsa i njëjti parametër të mos verifikohet ose të tolerohet te OE-të e tjerë.

“Sapun 100 gr. Me glycerin aromatic- ekologjik”

Gjithashtu, në FDT është përcaktuar se **nuk lejohen variantet**

Nga qasja në mostrat e operatorëve të tjerë rezulton:

- **PM GROUP – mostër 125 g**
- **KIGA – mostër 115 g**

Pra, asnjëra nga këto mostra nuk përputhet me peshën e kërkuar prej **100 g**. Nëse kërkesa prej 100 g është konsideruar kërkesë detyruese, atëherë duhet të sqarohet:

Për çfarë arsye operatorët ekonomikë që kanë dorëzuar mostra prej 115 g dhe 125 g nuk janë trajtuar njësoj si N.T.SH. GIPA? Veçanërisht kur vetë DT përcakton se nuk lejohen variantet.

**Qese te zeza per mbeturina {thas} 400*200*1.100*0.04 H.D.P.
(Haj.Densiti.Polietilen.) Tipi-FS471-02 —paketimi 1/10—120L**

**Qese te verdha per mbeturina {thas} 400*200*1.100*0.04 H.D.P.
(Haj.Desiti.Polietilen.) Tipi- FS471-02-- -paketimi 1/10—120L.**

**Qese te kuqe per mbeturina (thas) 1/10--- 120 L. 1/10 400*200*1.100*0.04
H.D.P. (Haj. Desiti polietilen) Tipi-FS471-02**

Sipas kërkesës së specifikacionit teknik qesja pas hapjes duhet të ketë 400mm me 200mm nga dy anet dhe gjatsi 1.100mm që kur hapet komplet qesja duhet të ketë 800mm gjërsi me 1.100mm gjatsi ndërsa në matjet e mostrave të dorëzuara nga KIGA DHE PM GROUP kemi rezultuar se ato kanë 700mm gjërsi dhe 1.050 gjatsi, po ashtu edhe trashësia e qeseve është më e vogël se 0.02

“Qese te zeza te vogela 350x200x7000x0.04mm H.D.P.(Haj.Densiti.polietilen.)Tipi-FS471-02---paketimi 1/10---- -70 L.”

Po ashtu edhe në qesen 70L është kërkuar që të jetë qesja pas hapjes 350mm me të dy anet nga 200mm dhe gjatësi 700mm mirpo gjat matjes është hasur në dimension tjetër më të vogël ku komplet hapja duhet të ishte 750mm ndërsa mostra është ofruar 480mm me 700mm dhe me trashësi prej 0.02

N.T.SH. GIPA nuk kërkon trajtim favorizues, por kërkon vetëm trajtim të barabartë dhe zbatim të njëjtë të kërkesave të Dosjes së Tenderit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Nëse AK ka konsideruar se mungesa e një parametri teknik është mospërputhje materiale dhe bazë për eliminim të GIPA-s, atëherë e njëjta qasje duhet të zbatohet edhe ndaj operatorëve të tjerë që kanë paraqitur mostra me të njëjtat ose me mospërputhje të tjera teknike.

Përndryshe, krijohet një situatë ku **i njëjti kriter i DT-së zbatohet në mënyrë të ndryshme ndaj operatorëve ekonomikë**, gjë që cenon barazinë e trajtimit dhe integritetin e procesit të vlerësimit.

Kërkoj nga Oshp-ja që ta shqyrtoj Ankesën tonë dhe ta pranoj si të bazuar dhe të ndryshoj vendimin për dhanje të kontratës dhe të kërkoj trajtim të barabart sipas ligjeve të KRPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania jonë si OE jemi të dëmtuarit në këtë tender-projekt, pasi konsiderojmë se nga AK janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së (të precizuara si më lartë) dhe është bërë shkelje pikorisht Neni 7 par. 1 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042 - Barazia në Trajtim Jo Diskriminimi.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.